



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-7343

Dt. 15.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Muharrem (Shaip) Kumnova** nga Gjakova, përmes përfaqësuesit ligjor (i biri) **Artan Kumonova** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për shëndërrimin e dhomës në lokal, në objektin ekzistues, me etazhitet P (përdhese), në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Muharrem (Shaip) Kumnova nga Gjakova, ndërtimi – shndërrimi i dhomës në lokal, në objektin ekzistues të kategorisë së parë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-7343 të datës 05.06.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5750/2, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën “Washingtoni”, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit, me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin – shndërrimin e dhomës në lokal, etazhiteti i objektit – dhomës e cila do të shndërrohet në lokal është P (përdhese), me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S=23.64 m²**.

Përdhesa - lokali: (Sip,Bruto): S= 23.64 m²

I. II. Hartimin e projektit me destinim: shndërrimi i dhomës në lokal pune, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore “REAL –PROJECT”- Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Muharrem (Shaip) Kumnova nga Gjakova, me banim në rrugën “Washingtoni” pn, përmes përfaqësuesit të tij ligjor – të birit Artan Kumnova, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-7343 të datës 03.04.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për dhënien e Lejes së Ndërtimit për shëndërrimin e dhomës në lokal, në objektin ekzistues, me etazhitet P (përdhese), në ngastrën kadastrale me nr. 5750/2, Z.K. Gjakovë – J- Qytet, në rrugën “Washingtoni”, në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 03.04.2017, të punuar nga NPSH”GELI”-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 31.03.2017 në pronësi të Muharrem (Shaip) Kumnova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 1803/17, të datës 29.03.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-7343 të datës 05.06.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin- shndërrimin e dhomës në lokal në ngastrën kadastrale me nr. 5750/2, ZK: Gjakovë-j-Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/530/01-12840 të datës 09.06.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430-a-1336 të datës 31.03.2017.
7. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në PTK-Vala, filiali në Gjakovë me datë 12.06.2017.
8. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese ndërtimore “REAL –PROJECT”-Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 30.75 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për punë Inspektuese,
- Arkivës.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.


U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë J. Qytet

Poseduesi: Kumnova Muharrem Shaip



Pronar: Muharrem Kumnova
Parcela: 5750-2 Z.K. Gjakovë J. Qytet
Shëndërimi i dhomës në lokal
Sipërfaqja S=26.0m²

Punoi: Durrije Berisha inxh. dip. ark.

Berisha

Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
5750-2			oborr			1	29	
			shtëpi			1	18	
Gjithsejtë						2	47	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

[Signature]